



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
SPORTIT DHE RINISE  
MINISTRI

Nr. 221 Prot.

Tiranë, më 10.01. 2018

## URDHËR

Nr. 6, datë 10.01.2018

PËR

### ZBATIMIN E NISMËS " TRI LËNDË NË GJASHTË ORË"

Në mbështetje të nenit 26 të ligjit nr. 69/2012, "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar,

#### URDHËROJ:

1. Institucionet arsimore të arsimit parauniversitar të zbatojnë nismën "Tri lëndë në gjashtë orë", sipas udhëzuesit bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij urdhri.
2. Kjo nismë të planifikohet në bazë institucioni arsimor dhe të zbatohet nga data 1 shkurt 2018 dhe në vijim.
3. Të gjitha rrjetet profesionale të organizojnë takime për zbatimin e udhëzuesit nga data 15 -30 janar 2018.
4. Ngarkohen për zbatimin e këtij Urdhri, njësitë arsimore vendore dhe institucionet arsimore të arsimit parauniversitar.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

LINDITA NIKOLLA

MINISTËR





REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT, SPORTIT DHE RINISË  
INSTITUTI I ZHVILLIMIT TË ARSIMIT



**UDHËZUES PËR ZBATIMIN E NISMËS**

**“TRI LËNDË NË GJASHTË ORË”**



## **1. Përshkrimi i nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”**

Reformat që kanë përfshirë aktualisht shkollën në lidhje me kurrikulën, mësimdhënien, vlerësimin e nxënësve, drejtimin e shkollës etj., kërkojnë ndryshime të cilat mbështesin dhe lehtësojnë zbatimin e këtyre reformave dhe njëkohësisht sigurojnë cilësinë e arritjeve në këtë proces.

Një prej ndryshimeve të nevojshme dhe të domosdoshme për përmirësimin e efektivitetit të procesit të nxënësve është rritja e fleksibilitetit të shkollës për të menaxhuar dhe për të organizuar orarin mësimor.

Në sistemin arsimor parauniversitar, për çdo ditë nxënësit zhvillojnë 4 – 6 orë mësimore/ditë, në varësi të nivelit të arsimit (në arsimin fillor 4-5 orë/ditë, në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë 5-6 orë/ditë). Ora e mësimit zgjat 45 minuta. Aktualisht, shkollat e ndërtojnë orarin mësimor duke planifikuar për çdo ditë lëndë të ndryshme, në varësi të numrit të orëve për secilën klasë, që do të thotë nxënësit zhvillojnë 4 – 6 lëndë në ditë.

Ky model i organizimit të orarit, i zhvilluar deri më tanë, në shumë raste sjell mbingarkesë të nxënësve, në lidhje me numrin e lëndëve që duhet të studiojnë për çdo ditë (deri në 6 lëndë/ditë), shqetësim i cili shoqërohet edhe me pasoja të tjera, si për shembull:

- Numri i madh i lëndëve që nxënësit zhvillojnë brenda një dite, sjell ngarkesë të përditshme të teksteve dhe të fletoreve, të cilat nxënësit duhet t'i marrin me vete në shkollë. Aktualisht, pesha e çantave që duhet të mbajë një fëmijë e tejkalon raportin peshë çantë / peshë trupore.
- Në shumë raste gjatë 45 minutave, për zhvillimin e disa lëndëve, mësuesit “marrin kohë” nga pushimet midis orëve ose nga orët e lëndëve të tjera “më pak të rëndësishme”.
- Në disa raste, nxënësve u mungon koha e nevojshme për të kryer detyra që kërkojnë zbatim të njojurive, punë në grup, punë të pavavarur etj.
- Etj.

Në kuadrin e ndryshimeve kurrikulare, nga vëzhgimet dhe bisedat e realizuara me nxënësit dhe mësuesit, koha prej 45 minutash, e planifikuar për një orë mësimore, shpesh rezulton e pamjaftueshme për kryerjen e të gjitha veprimtarive mësimore.

*Zgjidhja e problematikave të mësipërme dikton nevojën e rritjes së fleksibilitetit dhe të lirisë së shkollave për forma të reja të organizimit të orarit mësimor. Shkolla mund të riorganizojë orët mësimore të lëndëve, duke zhvilluar për një lëndë, 2(dy) orë mësimore të njëpasnjëshme (45 + 45), sigurisht me pushimin 5- minutësh ndërmjet tyre. Kjo do të thotë që nxënësi mund të zhvillojë në një ditë 3 lëndë të ndryshme dhe jo 6 lëndë të ndryshme.*



## **2. Përfitimet që sjellin format e reja të organizimit të orarit mësimor**

### **Për nxënësit:**

- Kanë mundësi të përvetësojnë më mirë njohuritë dhe të zhvillojnë aftësitë e tyre, pasi do të jetë më e madhe koha në dispozicion për zhvillimin e detyrate dhe të veprimtarive të ndryshme në funksion të të nxënëtit në klasë.
- Të ndërtuarit e të nxënëtit nga vetë nxënësit kërkon një kohëzgjatje më të madhe. Organizimi i situatave të të nxënëtit, bashkëveprimi ndërmjet nxënësve në klasë, reflektimi dhe vlerësimi, kërkojnë një shtrirje më të gjatë në kohë.
- Kanë mundësi të aktivizohen dhe të vlerësohen më shumë gjatë mësimit.
- Reduktohen detyrat e shtëpisë, në mënyrë të veçantë në lëndë të caktuara si gjuha shqipe, matematika, gjuha e huaj etj.
- Nuk janë të ngarkuar dhe të lodhur nga zhvillimi i 6 lëndëve mësimore brenda një dite.
- Përgatiten për një numër më të vogël lëndësh për ditën e nesërme.
- Nuk kanë çanta të mbingarkuara dhe me shumë libra dhe fletore.
- Në shkollat e nismës “Bëjmë detyrat në shkollë” do të përgatiten për një numër më të kufizuar lëndësh dhe do të kenë më shumë kohë dhe mundësi për t'u angazhuar në aktivitetet tjetra (lexim, veprimtari sportive, veprimtari artistike, mësimin e gjuhëve të huaja, klube për të talentet etj.).
- Krijojnë raporte më të qëndrueshme me mësuesit, për shkak të qëndrimit për një kohë më të gjatë së bashku.

### **Për mësuesit:**

- Kanë mundësi më shumë për të punuar me nxënësit për zhvillimin e kompetencave lëndore dhe të kompetencave kyç.
- Kanë më shumë kohë që të përdorin teknika, strategji dhe metoda mësimore, nëpërmjet të cilave nxënësit do të ndërtojnë njohuritë e reja, duke përbushur kështu një nga kërkesat kryesore të kurrikulës së re.
- Përgjatë 90 minutave (45 minuta + 45 minuta), mësuesi ka mundësi të planifikojë dhe të realizojë njohuritë e reja, punët praktike, detyrat apo vëzhgimet në natyrë, të zhvillojë eksperimente duke bërë një vlerësim më efektiv për nxënësit.



- E organizojnë më mirë mësimdhënien duke alternuar pjesën teorike me ushtrimet, praktikën, eksperimentet, punën e pavarur, punën në grup (p.sh., shumë herë eksperimentet ose ilustrimet në orën e mësimit anashkalohen nga mungesa e kohës).
- Realizojnë më me cilësi orë të tillë, si: disa nga punët me shkrim, projektet, prezantimi i portofoleve të nxënësve, punët e laboratorit, punët praktike etj., pasi zhvillimi i këtyre temave kërkon më shumë kohë.
- Kanë më shumë mundësi për të punuar me nivele të ndryshme nxënësish.
- Kanë mundësi të vëzhgojnë në mënyrë më të plotë sjelljet, ndërveprimin dhe të nxënësit e nxënësve.
- Kanë më pak përgatitje në planin ditor.

#### ***Zbatimi i kurrikulës:***

- Zhvillimi i lëndëve mësimore në dy orë të njëpasnjëshme brenda një dite është një praktikë që zbatohet edhe në vendet e tjera.
- Qëllimi i kurrikulës së re është që të ndërtojë dhe të zhvillojë kompetenca te nxënësit. Kjo do të thotë që gjatë orës së mësimit të përdoren metoda, teknika dhe strategji, të cilat do t'u mundësojnë nxënësve që të ndërtojnë vetë dijet dhe njohuritë e tyre. Shpesh 45 minuta është kohë e pamjaftueshme.
- Brenda dy orëve të njëpasnjëshme (90 minutave) nxënësit jo vetëm marrin njohuri, por edhe punojnë ushtrime, bëjnë punë të pavarura (individualisht ose në grup), nëpërmjet të cilave fitojnë aftësi dhe kështu të nxënët është me efektiv.
- Projektet që janë pjesë e rëndësishme e kurrikulës së re, pasi në to nxënësit zbatojnë në situata reale dhe konkrete, njohuritë dhe aftësitë e tyre, mund të zhvillohen dhe të prezantohen më lehtë në dy orë të njëpasnjëshme (90 minuta).
- Portofoli i nxënësit mund të ndiqet, të këshillohet dhe të vlerësitet më mirë brenda dy orëve të njëpasnjëshme.

#### ***Për vlerësimin e nxënësit:***

- Nxënësit kanë më shumë mundësi që të aktivizohen dhe rrjedhimisht edhe të vlerësohen më mirë nga mësuesit.
- Mësuesi ka më shumë kohë për të mbledhur informacione rrith përparimit të të nxënët dhe të kryejë vlerësim të nxënësit të bazuar në nivele arritjesh, por edhe për të plotësuar dokumentacionin (regjistër, evidencë etj.).



- Mësuesi ka më shumë kohë për të interpretuar arritjet e nxënësve.
- Reduktohet numri i testeve që nxënësit mund të zhvillojnë brenda një dite.
- Mësuesi ka më shumë kohë për të vlerësuar portofolet e nxënësve.

### **3. Udhëzime për menaxhimin e orarit mësimor nga shkollat në arsimin parauniversitar**

- Nisma “Tri lëndë në gjashtë orë” synon rritjen e autonomisë dhe të fleksibilitetit të shkollës për menaxhimin e orarit mësimor, në funksion të zbatimit të kurrikulës së bazuar në kompetenca dhe të përmirësimit të cilësisë së të nxënësve mësimdhënies, në arsimin parauniversitar.
- Kjo nismë do të zbatohet në të gjitha shkollat e arsimit bazë dhe arsimit të mesém të lartë.
- Referuar kësaj nisme, shkollat kanë lirinë dhe fleksibilitetin të riorganizojnë orët mësimore për secilën lëndë, të përcaktuara në planin mësimor të arsimit bazë dhe arsimit të mesém të lartë, duke bërë grupime të këtyre orëve.
- Brenda një dite mësimi, një lëndë mund të zhvillohet në dy orë mësimore të njëpasnjëshme (45 min + 45min), me 5 minuta pushim në mes. Pushimi i madh mund të zhvillohet pas 2 orëve të para. Dhe pas 2 orëve të dyta mund të bëhen 10 minuta pushim.

### **4. Rolet dhe përgjegjësítë**

#### ***Instituti i Zhvillimit të Arsimit:***

- Organizon takime informuese me specialistë të Njësive Arsimore Vendore lidhur me zbatimin e nismës “Tri lëndë në gjashtë orë”.
- Këshillon në mënyrë të vazhdueshme drejtuesit e rrjeteve profesionale në procesin e zbatimit të kësaj nisme.

#### ***Njësia Arsimore Vendore (NJAVA):***

- Informon drejtuesit e shkollave për qëllimet dhe përfitimet e kësaj nisme.
- Koordinon punën me shkollat për zbatimin e kësaj nisme.
- Këshillon dhe monitoron në mënyrë të vazhdueshme shkollat në procesin e zbatimit të kësaj nisme.
- Raporton periodikisht në MASR, për ecurinë e zbatimit të kësaj nisme.
- Komunikon në mënyrë të vazhdueshme me MASR-në dhe IZHA-n, për nevojat që lidhen me zbatimin e kësaj nisme.



### **Rrjetet profesionale:**

- Informojnë anëtarët e rrjeteve profesionale për qëllimet dhe përfitimet e kësaj nisme.
- Shkëmbjnë eksperiencia pozitive ndërmjet anëtarëve të rrjeteve profesionale për format e reja të organizimit të procesit mësimor sipas kësaj nisme.
- Zhvillojnë seanca trajnuese sipas profileve për planifikimin e kurrikulës, zbatimin e metodologjive të mësimdhënies dhe të vlerësimit të nxënësit, referuar formës së re të organizimit të orarit.

### **Staf drejtues i shkollës:**

- Organizon seanca informuese me stafin e shkollës, nxënësit, prindërit dhe përfaqësuesit e tjera të komunitetit për qëllimet dhe përfitimet e kësaj nisme.
- Zhvillon seanca trajnuese me stafin e shkollës për mundësitet që ofron fleksibiliteti i menaxhimit të orarit nga shkolla në lidhje me zhvillimin e kompetencave, format e reja të organizimit të procesit mësimor, vlerësimin e nxënësve etj.
- Koordinon punën me ekipet lëndore për hartimin dhe zbatimin e orarit të ri mësimor.
- Krijon infrastrukturën e nevojshme (laboratorët, mjediset sportive, kabinetet etj.) për zbatimin e orarit të ri mësimor.
- Harton orarin e ri mësimor.
- Monitoron në mënyrë të vazhdueshme procesin e zbatimit të kësaj nisme në shkollë.


### **Mësuesit:**

- Bashkërendojnë punën në ekipet lëndore për hartimin dhe zbatimin e orarit të ri mësimor nga shkolla.
- Rishikojnë dhe përditësojnë planifikimin lëndor në përshtatje të orarit të ri mësimor dhe të mundësive që ai krijon.
- Konsultohen në mënyrë të vazhdueshme me stafin drejtues të shkollës dhe përfaqësues të NJAV-ve për nevojat që u lindin gjatë këtij procesi.

## **5. Format e reja të organizimit të orarit mësimor**

*Format e reja të organizimit të orarit mësimor varen nga specifikat dhe nevojat e shkollës, që nënkupton infrastrukturën e shkollës (kabinetet, mjediset sportive, laboratorët etj.); numrin e*





mësuesve (provizorë dhe definitivë); zhvillimin e mësimit me turne; largësinë e shkollës nga vendbanimet (kur shkolla është larg, nxënësit mbajnë për një rrugë më të gjatë ngarkesën e çantës) etj. Më poshtë janë paraqitur disa modele të organizimit të orarit të shprehura në dy variante. Në variantin e parë është paraqitur një model orari i organizuar sipas një javë mësimore, ndërsa në variantin e dytë është paraqitur një model orari i organizuar sipas dy javëve mësimore (tek dhe çift).

## MODELE TË MENAXHIMIT DHE TË ORGANIZIMIT TË ORARIT NË SHKOLLË

VARIANTI 1: MODELI SIPAS NJË JAVE MËSIMORE

PLANI MËSIOR KLASA 3					
LËNDËT	ORËT	LËNDËT	ORËT	LËNDËT	ORËT
GJUHË SHQIPE	6	EDUKIM PËR SHOQËRINË	1	VIZATIM	1
GJUHË E HUAJ	3	DITURI NATYRE	1	EDUKIM FIZIK	3
MATEMATIKË	4	MUZIKË	1	KURRIKUL ME ZGJEDHJE	2
				KËRCIM	1
TOTALI 23 ORË					

ORA	E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE
1	GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	GJUHË SHQIPE
2	GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	GJUHË SHQIPE
3	GJUHË E HUAJ	EDUKIM PËR SHOQËRINË	MUZIKË	GJUHË E HUAJ	EDUKIM FIZIK
4	EDUKIM FIZIK	DITURI NATYRE	KURRIKUL ME ZGJEDHJE	GJUHË E HUAJ	KËRCIM
5	EDUKIM FIZIK		KURRIKUL ME ZGJEDHJE	VIZATIM	
6					

PLANI MËSIOR KLASA 8						
LËNDËT	ORËT	LËNDËT	ORËT	LËNDËT	ORËT	LËNDËT
GJUHË SHQIPE	5	KIMI	2	MUZIKË	1	
GJUHË E HUAJ 1	3	QYTETARI	1	VIZATIM	1	
MATEMATIKË	4	HISTORI	2	EDUKIM FIZIK	3	
FIZIKË	2	GJEOGRAFI	2	TIK	1	
BIOLOGJI	2			KURRIKUL ME ZGJEDHJE	2	
<b>TOTALI 31 ORË</b>						
ORA	E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE	E PREMTE
1	GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	GJUHË SHQIPE	
2	GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	KIMI	
3	GJUHË E HUAJ 1	HISTORI	BIOLOGJI	GJEOGRAFI	KIMI	
4	GJUHË E HUAJ 1	HISTORI	BIOLOGJI	GJEOGRAFI	TIK	
5	FIZIKË	KURRIKUL ME ZGJEDHJE	MUZIKË	GJUHË E HUAJ 1	EDUKIM FIZIK	
6	FIZIKË	KURRIKUL ME ZGJEDHJE	EDUKIM FIZIK	QYTETARI	EDUKIM FIZIK	
7	VIZATIM					

PLANI MËSIOR KLASA 10						
LËNDËT	ORËT	LËNDËT	ORËT	LËNDËT	ORËT	LËNDËT
GJUHË SHQIPE	2	FIZIKË		HISTORI	2	
LETËRSI	2	BIOLOGJI		GJEOGRAFI	2	
GJUHË E HUAJ 1	3	KIMI		TIK	2	
MATEMATIKË	4	QYTETARI	2	EDUKIM FIZIK	3	
				KURRIKUL ME ZGJEDHJE	2	
				TOTALI 30 ORË		

ORA	E HËNË	E MARTË	E MËRKURË	E ENJTE	E PREMTE
1	GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	LETËRSI	MATEMATIKË	GJUHË E HUAJ 1
2	GJUHË SHQIPE	MATEMATIKË	LETËRSI	MATEMATIKË	GJUHË E HUAJ 1
3	KIMI	FIZIKË	KURRIKUL ME ZGJEDHJE	BIOLOGJI	HISTORI
4	KIMI	FIZIKË	KURRIKUL ME ZGJEDHJE	BIOLOGJI	HISTORI
5	GJEOGRAFI	GJUHË E HUAJ.1	QYTETARI	EDUKIM FIZIK	TIK
6	GJEOGRAFI	EDUKIM FIZIK	QYTETARI	EDUKIM FIZIK	TIK
7					

**VARIANTI 2: MODELLI SIPAS DY JAVËVE MËSIMORE (TEK DHE ÇIFT)**

		<b>KLASA — 3 — JAVA — TEK —</b>				PLANI MESIMOR
ORA	E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE	PLANI MESIMOR
1	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	GJUHE SHQIPE
2	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	GJUHE E HUAJ
3	GJUHE E HUAJ	EDUKIM PËR SHOQERINË	VIZATIM	GJUHE E HUAJ	KURRIKUL ME ZGJEDHJE	MATEMATIK E
4	GJUHE E HUAJ	EDUKIM PËR SHOQERINË	VIZATIM	GJUHE E HUAJ	EDUKIM FIZIK	EDUKIM PËR SHOQERINË
5	EDUKIM FIZIK	EDUKIM FIZIK	KERCIM	KURRIKUL ME ZGJEDHJE	DITURI NATYRE	DITURI NATYRE
			<b>KLASA — 3 — JAVA — CIFT —</b>		MUZIKE	MUZIKE
ORA	E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE	VIZATIM
1	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	EDUKIM FIZIK
2	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	K.ZGJEDHJE
3	GJUHE E HUAJ	DITURI NATYRE	MUZIKE	KURRIKUL ME ZGJEDHJE	KURRIKUL ME ZGJEDHJE	KERCIM
4	GJUHE E HUAJ	DITURI NATYRE	MUZIKE	EDUKIM FIZIK	EDUKIM FIZIK	TOTAL
5		EDUKIM FIZIK	KERCIM			23

		KLASA — 8		JAVA — TEK			
ORA	E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE	PLANI MESIMOR	
1	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	GJUHE SHQIPE	5
2	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	GJUHE E HUAJ	3
3	GJUHE E HUAJ 1	HISTORI	BIOLOGJI	GJEOGRAFI	TIK	MATEMATIKE	4
4	GJUHE E HUAJ 1	HISTORI	BIOLOGJI	GJEOGRAFI	TIK	QYTETARI	1
5	FIZIKE	GJUHE E HUAJ 2	MUZIKE	KIMI	VIZATIM	FIZIKE	2
6	FIZIKE	GJUHE E HUAJ 2	MUZIKE	KIMI	EDUKIM FIZIK	BIOLOGJI	2
7			EDUKIM FIZIK		EDUKIM FIZIK	KIMI	2
		KLASA — 8		JAVA — CIFT			
ORA	E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE	GJEOGRAFI	2
1	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	FIZIKE	MUZIKE	1
2	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	FIZIKE	VIZATIM	1
3	GJUHE E HUAJ 1	GJEOGRAFI	BIOLOGJI	GJUHE E HUAJ 2	HISTORI	EDUKIM FIZIK	3
4	GJUHE E HUAJ 1	GJEOGRAFI	BIOLOGJI	GJUHE E HUAJ 2	HISTORI	TIK	1
5	EDUKIM FIZIK	VIZATIM	GJUHE E HUAJ 1	KIMI	QYTETARI	K.Z.GJ.HUAJ 2	2
6	EDUKIM FIZIK	VIZATIM	GJUHE E HUAJ 1	KIMI	QYTETARI	TOTAL	31
7			EDUKIM FIZIK				

		KLASA — 10			JAVA — TEK				
ORA	E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE			PLANI MESIMOR	
1	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	LETESRI	MATEMATIKE	GJUHE E HUAJ 1			GJUHE SHQIPE	
2	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	LETESRI	MATEMATIKE	GJUHE E HUAJ 1			LETESRI	
3	KIMI	FIZIKE	GJUHE E HUAJ 2/ ARTE	BIOLOGJI	HISTORI			GJUHE E HUAJ 1	
4	KIMI	FIZIKE	GJUHE E HUAJ 2/ ARTE	BIOLOGJI	HISTORI			MATEMATIKE	
5	GJEOGRAFI	QYTETARI	TIK	EDUKIM FIZIK	EDUKIM FIZIK			FIZIKE	
6	GJEOGRAFI	QYTETARI	TIK	EDUKIM FIZIK	EDUKIM FIZIK			BIOLOGI	
7								KIMI	
		KLASA — 10			JAVA — CIIFT				
ORA	E HENE	E MARTE	E MERKURE	E ENJTE	E PREMTE			QYTETARI	
1	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	LETESRI	MATEMATIKE	GJUHE E HUAJ 1			HISTORI	
2	GJUHE SHQIPE	MATEMATIKE	LETESRI	MATEMATIKE	GJUHE E HUAJ 1			GJEOGRAFI	
3	KIMI	GJUHE E HUAJ 1	GJUHE E HUAJ 2/ ARTE	FIZIKE				TIK	
4	KIMI	GJUHE E HUAJ 1	GJUHE E HUAJ 2/ ARTE	FIZIKE	BIOLOGJI			EDUKIM FIZIK	
5	GJEOGRAFI	TIK	QYTETARI	HISTORI	EDUKIM FIZIK			K.Z-GJ.HUAJ	
6	GJEOGRAFI	TIK	QYTETARI	HISTORI	EDUKIM FIZIK			2/ARTE	
7								TOTAL	